



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës së Junikut;
Komiteti për Politikë dhe Financa;
Numër: 02-09/22;
Datë: 14.10.2022 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa iu bënë këtë:

FTESË

Për: anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa;
Nga: Shpejtim Gacaferi – kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa;
Lënda: mbledhja e nëntë (2022) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa;
Vendi: salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 20.10.2022, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raport i kryetarit të Komunës së Junikut rreth gjendjes ekonomiko-financiare të Komunës së Junikut për periudhën korrik-shtator 2022;
3. Formimi i komisionit për plotësim – ndryshim të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2023;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për hartimin e rregullores për Institucionet edukativo – arsimore të Komunës së Junikut;
5. Të ndryshme;



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

KOMITETI PER POLITIKË DHE FINANCA

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 02-08-22

Datë: 20. 09. 2022, ora 10⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen e Tetë të Rregullt të Komitetit për Politike dhe Financa në Junik, të mbajtur më datë 20 Shtator, 2022, në orën 10⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Shpejtim Gacaferi, kryesues (LDK),
2. Ermelinda Lolluni, përfaqësuese (LDK),
3. Rajmonda Krasniqi, përfaqësuese (AAK),
4. Xhemë Tofaj, përfaqësues (LVV), dhe
5. Dervish Bajraktari, përfaqësues (AAK).

Poashtu të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari Komunës, z. Besart Tofaj, drejtoresha për Buxhet dhe Financa znjsh. Vjollca Qestaj, zyrtari Kryesor Financiar z. Arten Hamza, dhe zyrtarja për Tatim në Pronë znj. Saranda Isufaj.

Mbledhjen e Tetë të Rregullt të Komitetit për Politike dhe Financa e shpalli të hapur kryesuesi i këtij Komiteti, z. Shpejtim Gacaferi, ndërsa tha, e cekë se nga pesë anëtarë të KPF-së të gjithë jemi të pranishëm në këtë mbledhje.

Kryesuesi paraqiti dhe kërkoi miratimin e Rendin e Ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Formimi i Grupit të Punës për hartimin e Projekt-Planit të Punës të Komunës së Junikut për vitin 2023,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023-2025,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim-ndryshimeve të Projekt-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2023,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2023,
6. Bartja dhe rritja e të Hyrave Vetanake,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Kadastër dhe Mjedis, për përmirësimin teknik të emrave të rrugëve, dhe
8. Të ndryshme.

Rendi i Ditës u miratua me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika e Parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Pas shqyrtimit nga anëtarët e KPF-së, me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua kjo pikë e Rendit të Ditës.

Pika e Dytë

Formimi i Grupit të Punës për hartimin e Projekt-Planit të Punës të Komunës së Junikut për vitin 2023

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi tha, e kemi si obligim formimin e këtij grupi që përbëhet nga pesë anëtarë. Kryesuesi i këtij Komisioni jam unë në bazë të Rregullores. Këta anëtarë të Komisionit vijnë nga tri subjektet politike, secila nga një anëtar, një nga ekzekutivi dhe Kryesuesi. Propozimet për emra bëhen në Kuvend.

Z. Shpejtim Gacaferi kërkoi miratimin e kësaj pike, e cila me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratohet nga anëtarët e KPF-së.

Pika e Tretë

Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023-2025

Z. Shpejtim Gacaferi tha, pas pranimi të materialit dhe dëgjimit publik që ka organi i KPF-së së bashku me Kuvendin dhe Drejtorinë e Financave projekt-buxheti ka pësuar disa ndryshime, të cilat to t'i shpjegoj z. Arten Hamza.

Z. Arten Hamza tha, material ka një gabim teknik te tabela 4.1, te e cila mungojnë 3000.00 E te kategoria e mallrave dhe shërbimeve në QKMF, por buxheti i cili është 1,877,346.00 E mbetet i njëjtë. Sa i përket Qarkores Buxhetore të Kornizës Afatmesme Buxhetore, gjatë dëgjimit publik kemi pas disa propozime nga pjesëmarrësit e pranishëm, të cilat po i lexoj, dhe nëse jeni për përfshirjen e tyre në KAB, pra me këto ndryshime. KAB është e njëjta që është miratuar në Qershor 2022, ndryshime ka nga faqja 7 e KAB-it. Pas pranimit të Qarkores së Parë Buxhetore të datës 15/08/2022 janë reflektuar ndryshimet. Mirëpo në Qarkoren e Dytë të shpjeguar edhe në Kuvend, kemi pasur ndryshime të këtyre kufijve, ku kemi pas zvogëlim në kategorinë e Kapitaleve për 15,000.00 E, d.m.th. këtu është i sqaruar ky ndryshim, ku janë specifikuar kategoritë shpenzuese. Po ashtu nëpër të gjitha drejtoritë ku ka pas ndryshime të buxhetit janë të reflektuara. Nëse krahasohen me KAB të Qershorit janë me pozicione të reja që janë paraparë sipas Qarkores së Dytë Buxhetore.

Sa i përket listës së projekteve kapitale gjithashtu ka ndryshime me KAB që e kemi pasur, sepse kemi mbajtur edhe dy dëgjime tjera publike, ku kanë reflektuar kërkesat e qytetarëve nga dëgjimet publike, edhe i vetmi ndryshim këtu është që nuk janë të prezantuara projektet apo propozimet nga dëgjimi i fundit publik, që nëse konsiderohen të nevojshme të shtohen, atëherë kemi afat deri në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit, që t'i paraqesim në këtë listë të prioriteteve kapitale. D.m.th. dëgjimi publik që është mbajtur nga Kryesuesi i Kuvendit me datë 16 Shtator, kanë dal këto propozime; asfaltimi i rrugës në Gjocaj, ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Kallavaj, ndërtimi i murit mbrojtës në lagjen Tofaj, ndërtimi i kanalit të ujitjes në lagjen Miroc-Ledina, ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Shafrane, ndërtimi i kanalit rreth lapidarit në lagjen Qok, rregullimi i parkut të lodrave të fëmijëve ose largimi i tyre në lagjen Qok, rregullimi i oborrit tek zjarrfikësit, dhe zyra për informim turistik. D.m.th. këto janë propozimet e reja gjatë takimit të fundit, dhe nëse pajtoheni këto mund t'i vendosim në Kornizën Afatmesme Buxhetore.

Sa i përket tabelave për vitin 2023 stafi i punonjësve i miratuar është 167, ky numër është i shpërndarë në secilin program, pra kemi rritje të stafit për 4 persona. Kategoria e pagave dhe mëditjeve në total është 1,170,906.00 E, kategoria e mallrave dhe shërbimeve 236,740.00 E, shpenzime komunale 37,700.00 E, subvencione 5,200.00 E, dhe projekte kapitale 380,000.00 E. Në total buxheti është 1,877,046.00 E.

Sa i përket shumës së projekteve kapitale propozimet janë të bashkangjitura të tabela 4.2, ku janë të propozuara këto projekte; në arsimin fillore është rregullimi i hapësirave sportive, rekreative të ambientit. Ky projekt ka qenë i planifikuar për këtë vit, por për shkak të mos përfundimit të punimeve nuk mund të realizohet këtë vit. Kështu që shtohet për vitin e ardhshëm. Në zhvillimin ekonomik është bashkëfinancimi i projekteve për vitin e ardhshëm ku janë ndarë 50,000.00 E për hapjen e rrugëve fushore në lokacionet Trojet, Shafrane dhe Gjocaj, ky është projekt në vlerën prej 10,000 E, pastaj ndërtimi kanaleve të ujitjes në vlerë prej 20,000.00 E, për të cilat segmente janë të përfshira në këtë shumë.

Te infrastruktura rrugore është rehabilitimi i rrugëve lokale prej 15,000.00 E, projekt ky në vazhdimësi në këtë vit, varësisht aty ku e paraqet nevoja, ndriçimi i hapësirave publike

përgjatë shtratit të lumit Erenik prej 20,000.00 E, ndërtimi i shtegut për biçikleta përgjatë stratit të lumit Erenik 10,000.00 E, dhe hapja dhe rregullimi i rrugës në fshatin Gjocaj. Te Urbanizmi është ndërtimi i kanalizimit sekondar, sipas informatës nga Pepshi deri në Gaxherr, dhe në Qendrën e Komunës së Junikut, dhe rekonstruimi i rrugës Gaxherr-Bajraktar, në shumën prej 140,000.00 E. Në Administratë është furnizimi me gjeneratorë për objektin e Komunës për 15,000.00 E, dhe blerja e një automjeti për nevojat e Komunës në vlerë prej 20,000.00 E. Në QKMF është ndërtimi i rrethojës dhe rregullimi i oborrit të QPS-së dhe QKMF-së. Këto do të jenë projekte në vazhdimësi për vitet tjera, d.m.th., vlera e këtyre projekteve në total është 380,000.00 E, nga granti qeveritar janë 256,570.00 E, kurse nga të hyrat vetanake janë 123,430.00 E.

Z. Dervish Bajraktari tha, unë kisha dashtë që këtu të jenë edhe drejtorët përkatës, sepse kemi pyetje sa i përket planifikimit që kanë bërë për projektet për vitin 2023, p.sh. hapja e rrugëve fushore në lokacionet Troje, Shafrane, dhe Gjocaj për 10,000.00 E, që nuk besoj se janë të mjaftueshme. Tjetër është rregullimi me drita, dhe blerja e automjetit të Komunës, ku sipas meje 20,000.00 E janë shumë, ndërsa shuma e mbetur të përdoret diku tjetër. Pra, kjo veturë sipas meje është luks. Sa i përket grupit të Aleancës, ne do të abstenojmë projekt-buxhetin për shkak të parregullsive, keqmenaxhimit dhe shpërndarjes së mjeteve nëpër projektet që i ceka.

Z. Arten Hamza tha, këto janë projekte të propozuara tre vjeçare, këto janë shuma vetëm për vitin 2023. Hapja dhe rregullimi i rrugës në fshatin Gjocaj, hapja e rrugëve fushore Troje, Shafrane dhe Gjocaj për vitin 2023 është 10,000.00 E, për vitin 2024 është 15,000.000 E, dhe për vitin 2023 parashihen 15,000.00, d.m.th. gjithsej 40,000.00 E. Pra, këto janë rrugë fushore ku bëhet hapja dhe shtruarja me zhavorr. Sa i përket veturës së Kryetarit, është e vërtetë se kjo veturë është blerë në vitin 2020, e cila me buxhetin e lejuar është blerë për 30,000.00 E, ndërsa për veturën e re janë ndarë 20,000.00 E, që unë vështirë besoj që mund të blihet në atë shumë. Kjo veturë do të përdoret për nevojat e Komunës, sepse nuk e kemi asnjë veturë në gjendje të rregullt teknike, përpos veturës së Kryetarit.

Z. Xhemë Tofaj tha, Komuna ka dhjetë vetura për të cilat po thua se nuk janë në funksion, mirëpo ju paguani sigurime për ato!

Z. Arten Hamza tha, Komuna e Junikut vetura ka blerë vetëm në vitin 2006. Dy vetura, në vitin 2010 është blerë një veturë për Kryetarin, dhe në vitin 2020 është blerë edhe një tjetër për Kryetarin, d.m.th. për Administratë. Pra, që nga viti 2006 nuk kemi vetura tjera të blera, përpos veturave Toyota të falura nga Ministritë, të cilat na i kanë dhënë në shfrytëzim, por të cilat nuk janë në gjendje të mirë, sidomos për udhëtimet në Prishtinë. Blerja e kësaj veture është e planifikuar dhe sipas tabelës për blerjen e automjetit për 20,000.00 E, 15,000.00 E janë na granti dhe 5,000.00 E nga të hyrat vetanake.

Znj. Rajmonda Krasniqi tha, deshta të bëj një propozim për lagjen Qok, te shtëpia e Sadri Rexhepit, ku ujërat e zeza zbrazen në kanal, ndërsa kanali i ujitjes aty është i ndërprerë. Do të ishte mirë që të shikohet, sepse po kundërmon dhe rrezikon shëndetin e banorëve në këtë lagje.

Z. Shpejtim Gacaferi tha, kemi pasur një ankesë lidhur me këtë nga z. Ibish Krasniqi në një dëgjim buxhetor. Kjo ka qenë edhe një kërkesë me nënshkrime të banorëve, e cila ka shkuar në Drejtorinë e Urbanizmit.

Z. Arten Hamza tha, kërkesa është, dhe këtë do ta sqaroj përmes drejtorit të Urbanizmit në mbledhje e Kuvendit, dhe shpresoj që kjo do të rregullohet.

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi hodhi në votim miratimin e këtij buxheti me ndryshimet e cekura, d.m.th. me tri vota për, asnjë kundër dhe dy abstenime kalon nga KPF-ja buxheti për vitin 2023.

Pika e Katërt

Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim-ndryshimeve të Projekt-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2023

Z. Shpejtim Gacaferi tha, kemi kërkesë nga drejtoresha për Buxhet dhe Financa, dhe fjalën ia kaloj drejtoreshës.

Znjsh. Vjollca Qestaj tha, unë po filloj ta prezantoj para juve raportin e Grupit Punues për plotësim-ndryshimi e normave tatimore në Pronën e Paluajtshme. Ne më herët si drejtori e Financave kemi bërë kërkesë në KFP dhe Kuvend që të na lejohet fillimi i procedurave për plotësim-ndryshimin e kësaj Rregulloreje. Rregulloren nuk e kemi sjellë pasi që aty nuk ka ndonjë ndryshim, ndërsa te ju e kemi dërguar vetëm raportin. Mirëpo, edhe në këtë raport, nga rekomandimet e dala nga ky grup punues i cili është formuar me vendim të Kryetarit, dhe pas takimeve nga ky grup punues kanë dal me rekomandimi që normat për vitin 2023 të mbeten të njëjta për tri vite. Vlerësimi i fundit i këtyre normave është bërë në vitin 2020, mirëpo për shkak të gjendjes pandemike është vendosur që të vazhdohet njëjtë edhe në vitin 2021. Poashtu këto norma tatimore mbeten të njëjta edhe për vitin 2020.

Në tabelë janë të prezantuara kategoritë e pronës dhe normat tatimore, ku vlera minimale është 0.15%. pra, këto ndryshime lejohet të ndodhim njëherë në tri deri në pesë vite.

Zyrtarja e Tatimit në Pronë znj. Saranda Isufaj tha, Kuvendi Komunal e ka për obligim që çdo vit ta paraqet për shqyrtim në procedurë të rregullt, por kjo nuk do të thotë që është obligative të ndryshohet.

Ministria e Financave bën vlerësimin njëherë në tri deri në pesë vite. Këtë vit është duke u bërë një vlerësim, dhe në bazë të raportit të vlerësimit mundem që deri në vitin e

ardhshëm të bëhen ndryshime për normat tatimore. Kjo normë momentalisht është në minimale, pra 0.15%, për të gjitha kategoritë.

Kryesuesi hodh në votim këtë pikë, dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratohet kjo pikë e Rendit të Ditës.

Pika e Pestë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2023

Z. Shpejtim Gacaferi tha, kemi kërkesë poashtu nga drejtoresha për Ekonomi dhe Zhvillim, dhe në bazë të ligjeve në fuqi, na është drejtuar neve si KPF dhe Kuvend, që të jepet e drejta për formimin e Grupit Punues, pastaj na vjen për lexim të parë materiali për nxjerrjen e së drejtës për fillimin e procedurave për ndryshim-plotësim të kësaj Rregulloreje për Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik.

Ndonjë material tjetër nuk e kemi, as drejtoreshën nuk e kemi këtu sot, mirëpo kjo Rregullore duhet të kalojë çdo vit për rishqyrtim në Kuvend.

Kryesuesi hodhi në votim ndryshim-plotësimin e kësaj Rregulloreje, dhe me pesë vota për, asnjë kundër, dhe asnjë abstenim miratohet nga KPF-ja.

Pika e Gjashtë

Bartja dhe rritja e të Hyrave Vetanake

Z. Arten Hamza tha, kjo kërkesë ka të bëjë me ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2022. Siç e dini në planifikimin e të hyrave vetanake që kemi bërë vitin e kaluar për inkasimin e hyrave vetanake për vitin 2022 në total është 159,038.00 E. Sipas kategorive që janë të prezantuara planet dhe realizimet; nga Shërbimet e Kadastrës janë 11,481.00 E, nga Urbanizmi 19,100.00 E, nga Administrata 7,100.00 E, nga lejet për Veprimtari Biznesi 10,000.00 E, nga Tatimi në Pronë dhe Toka 92,557.00 E, Regjistrimi i Automjeteve 6,000.00 E, nga Shëndetësia (participimi) 62,000.00 E, nga Shërbimet e Inspektimit 4,100.00 E, dhe të hyrat tjera 2,500.00 E.

Në total plani i të hyrave është 159,038.00 E. Këto janë miratuar si të hyra për vitin 2022.

Për periudhën Janar-Gusht 2022 inkasimi i të hyrave vetanake, duke përfshirë edhe gjobat në trafik të cilat nuk planifikohen nga niveli lokal, por ai qendror, dhe barten në baza tre mujore për alokim në nivel lokal. Deri në këtë periudhë inkasimi është 300,757.19 E, që ka tejkalim për 141,719.00 E. Të hyrat nga shërbimet e kadastrës për Janar-Gusht janë 191,924.75 E, që ka tejkalim për 189,424.75 E. Kjo e hyrë ka qenë tek ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ku është pëlqimi për ndërtimin e solareve. Pra, vetëm nga ajo taksë dhe disa gjobave të gjykatave kemi pasur mbi 180,000.00 E, që është komplet rritja e prezantuar. D.m.th., shuma total e inkasuar për periudhën Janar-Gusht është 300,757.19 E.

Shuma e planifikuar për vitin 2022 është 159,038.00E, ku ka tejkalim të të hyrave për 141,719.19 E, ku janë të përfshira edhe gjobat në trafik prej 2,622.50 E.

Në mënyrë që të mundemi ta alokojmë tejkalimin e të hyrave, kërkojmë që të rritet planifikimi i të hyrave vetanake në shumë prej 141,719.19 E.

Totali i të hyrave vetanake për vitin 2022 të rritet nga 159,038.00 E në 300,757.19 E, d.m.th. kjo është vetëm për periudhën Janar-Gusht. Do të kemi prapë rast për rritjen e të hyrave vetanake në Janar të vitit tjetër.

Sipas propozimeve tona, pra ekzekutivit, kjo vlerë prej 141,719.19 E është propozuar të bartet si në vijim:

Në programin e Zhvillimit Ekonomik në kategorinë e shpenzimeve kapitale në projektin bashkëfinancimi projekteve janë planifikuar të barten 80,000.00 E, poashtu kategorinë e shpenzimeve kapitale, projekti-ndërtimi i kanaleve të ujitjes, punë shtesë në këtë projekt në vlerë prej 2,000.00 E. Në programin e Urbanizmit-në kategorinë e shpenzimeve kapitale poashtu, asfaltimi i rrugëve lokale në vlerë prej 80,000.00 E, edhe ky është projekt ekzistues, projekt tre vjeçar, që është përmbyll tani. Vlera e të cilit ka qenë mbi 79,000.00 E, dhe këtu është kërkuar 10 % punë shtesë me vlerë maksimale deri në 8,000.00 E të barten në këtë projekt. Pastaj, në programin e Arsimit Fillor-në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 10,000.00 E, për shkak të rritjes së çmimit të druve. Në programin e Shërbimeve Publike-mallra dhe shërbime është kërkuar shuma prej 10,000.00 E për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, si dhe për menaxhimin e mbeturinave. Në programin e Urbanizmit-kategoria mallra dhe shërbime është kërkuar shuma prej 31,719.19 E, me arsyetimin për hartimin e projekteve, siç është projekti i Qendrës së Junikut, i planifikuar për turizëm. Pra, këto janë propozimet që i kanë bërë drejtoritë, të cilat drejtorët mund t'i sqarojnë me detalisht në Kuvend.

Z. Xhemë Tofaj kërkoj të di se cilat janë punët shtesë të projektet e lartpërmendura, siç janë kanalet e ujitjes dhe menaxhimi i mbeturinave.

Z. Arten Hamza tha, për detajet e këtyre projekteve mund të përgjigjen drejtorët e drejtorive përkatëse.

Kryesuesi hodhi në votim këtë pikë, dhe me tri vota për, asnjë kundër dhe dy abstenime miratohet bartja dhe rritja e të hyrave vetanake.

Pika e Shtatë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Kadastër dhe Mjedis, për përmirësimin teknik të emrave të rrugëve

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi tha, kemi një kërkesë nga drejtori për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, ku gjatë punimit të listës së emrave kanë hasur në disa gabime teknike. Ne nuk jemi duke ndryshuar emrat e rrugëve por vetëm bëjmë përmirësimet e disa emrave aty ku ka pa pasur gabime. Në bazë të Rregullores këto ndryshime kalojnë

përmes Kuvendit, i cili nuk ka nevojë të ketë Komision, sepse këto janë vetëm ndryshime teknike.

Z. Dervish Bajraktari pyeti nëse është e mundur që të bëhet ndryshimi i emrave të rrugëve në bazë të Rregullores.

Z. Shpejtim Gacaferi tha, me sa di unë kjo nuk mund të bëhet në periudhën prej viteve.

Kryesuesi hodhi në votim këtë kërkesë, dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratohet kjo kërkesa në fjalë.

Pika e Tetë Të ndryshme

Z. Xhemë Tofaj kërkoj pjesëmarrjen e drejtorëve në mbledhjet e KPF-së, poashtu të njëjtën e kërkoj edhe z. Dervish Bajraktari i cili shtoj se nëse kjo përsëritet në mbledhjet e ardhshme, ne anëtarët e subjektit të AAK-së në përbërjen KPF-së do të nënshkruhem por do të abstenojnë në mbledhjet e KPF-së.

Z. Shpejtim Gacaferi tha, në bazë të ligjit ne duhet t'i drejtohem Kryetarit të Komunës, ndërsa në mungesë të tij është Nënkryetari, atëherë a donë këta që t'i kalojnë përgjegjësitë të drejtorët është çështje e tyre, dhe ne në këtë rast këtu kemi Nënkryetarin.

Z. Dervish Bajraktari tha, edhe nëse i drejtohem Nënkryetarit, ky mund të mos i ketë përgjigjet për çështjet apo pyetjet e caktuara.

Shpejtim Gacaferi tha, drejtorëve në këtë rast u lejohet që përgjigjet t'i japin në mbledhjen e Kuvendit ose të përgjigjen me shkrim në afatin prej 30 ditëve.

Me kaq, kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi e shpalli të mbyllur këtë mbledhje të KPF-së.

Gëzim Geci-Procesmbajtës

Shpejtim Gacaferi-Kryesues



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
DI/Nr. Proq. 2-155/9209
Njo. Org. 17
Nr. i faq. 12/10/2022
Data



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATË/A:	12.10.2021
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal, Junik
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës, Junik
NGA/OD/FROM:	Znj. Vjollca Qestaj – Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e KPF-së dhe Kuvendit komunal Raportin periodik të Buxhetit Janar-Shtator 2022.

Në bazë të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr: 031./048 neni 45, paragrafi 45.4 ku është detyrë e Ekzekutivit që në periudha tremujore dhe vjetore të raportojë para Kuvendit Komunal, atëherë kërkojmë që të shtohet në rend dite në mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe në mbledhjen e Kuvendit Komunal raportin periodik Janar-Shtator mbi Buxhetin dhe Shpenzimet për vitin 2022.

Të bashkangjitur në kërkesë keni raportin e përgatitur nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF
KOSOVO



KOMUNA E JUNIKUT
OPSTINA JUNIK/ MUNICIPALITY OF JUNIK

KOMUNA E JUNIKUT

RAPORTI I BUXHETIT KOMUNAL PËR PERIUDHËN JANAR - SHTATOR/ 2022

Junik, Tetor -2022

Informata -III- Financiare Periodike 2022

Kërkesat për raportim

Informata Financiare Komunale për periudhën Janar – Shtator 2022, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 46.1 dhe 46.2 të Ligjit Nr. 03/L-048 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” dhe statutit Komunal.

Informata Financiare Komunale Periodike ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesve do të prezantohet për 14 programet buxhetore :

1. Zyra e Kryetarit
2. Kuvendi Komunal
3. Administrata e Përgjithshme
4. Buxhet dhe Financa
5. Zhvillim Ekonomik
6. Shërbimet publike dhe Inspeksion
7. Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis
8. ZKK (Zyra Komunale për Komunitete)
9. Shëndetësi
10. Mirëqenie Sociale
11. Shërbimet e kujdesit primar
12. Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
13. Arsimi i mesëm
14. Arsimi fillor

TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik) të bazuar në para të gatshme “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”. Shënimet në pasqyrat financiare paraqesin pjesë integrale për ta kuptuar pasqyrën, andaj duhet të lexohen së bashku me pasqyrat.

Pasqyrat financiare janë për Komunën e Junikut. Komuna e Junikut kontrollohet nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha aktivitetet e saja financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Komuna e Junikut nuk operon me llogarinë e vët bankare. Qeveria operon me funksion të centralizuar të Thesarit i cili e administron pranimin e parave të gatshme të mbledhura nga të gjitha entitetet buxhetore gjatë vitit financiar. Pagesat e bëra në këtë llogari sa i përket Komunës së Junikut janë të paraqitura në kolonën e llogarisë së vetme të Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave të Parave të Gatshme.

Buxheti i aprovuar në Asamblenë Komunale për vitin 2022 është në vlerë **1,658,591.00€** i cili ka pësuar ndryshime gjatë periudhës Janar – Shtator 2022 për të hyrat nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2021 në vlerë **2,469.85€**, Bartja e të hyrave të pashpenzuara të vitit 2021 të bartura për shpenzim në vitin 2022 në shumë prej **91,915.99€**, nga niveli Qendror është rritur kategoria e pagave në shume prej **15,522.04€** për mbulimin e shtesave për përfituesit nga Ligji për rimëkëmbje

ekonomike për punëtorët shëndetësor në QKMF. Buxheti përfundimtar i përgjithshëm duke përfshirë edhe donacionet është në vlerë **1,768,498.88€**.

Raport i ekzekutimit të Buxhetit

	Buxheti fillestar	Buxheti Aktual	Pranimet - Alokimet	Pagesat (Shpenzimi)	Progresi me plan	% me alokim
Përshkrimi	Ligji Nr. 07-L-041	SIMFK	SIMFK		në, %	në, %
a	b	c	d	e	f=e/c	g=c/d
Gjithsej Pagesat	1+2+3+4+5	1+2+3+4+5	1+2+3+4	1+2+3+4+5		
Totali	1,658,591.00	1,768,498.88	1,420,793.66	1,122,515.92	63.47%	79.01%
Paga dhe Meditje	1,154,611.00	1,170,133.04	822,427.82	787,088.96	67.26%	95.70%
Mallrat dhe Shërbimet	202,780.00	209,797.50	209,797.50	148,311.43	70.69%	70.69%
Shpenzimet Komunale	36,200.00	36,200.00	36,200.00	23,713.04	65.51%	65.51%
Subvencione dhe Transferet	50,000.00	58,950.00	58,950.00	53,885.82	91.41%	91.41%
Investimet Kapitale	215,000.00	293,418.34	293,418.34	109,516.67	37.32%	37.32%
Granti i Përgjithshëm	1	1,499,553.00	1,515,075.04	1,012,108.93	66.80%	86.70%
Paga dhe Meditje	1,154,611.00	1,170,133.04	822,427.82	787,088.96	67.26%	95.70%
Mallrat dhe Shërbimet	196,580.00	196,580.00	196,580.00	144,144.93	73.33%	73.33%
Shpenzimet Komunale	36,200.00	36,200.00	36,200.00	23,713.04	65.51%	65.51%
Subvencione dhe Transferet	20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00	100.00%	100.00%
Investimet Kapitale	92,162.00	92,162.00	92,162.00	37,162.00	40.32%	40.32%
Rezerva	2	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Investimet Kapitale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Të hyrat vetanake	3	159,038.00	159,038.00	91,541.54	57.56%	57.56%
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet	6,200.00	6,200.00	6,200.00	-	0.00%	0.00%
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet	30,000.00	30,000.00	30,000.00	29,186.87	97.29%	97.29%
Investimet Kapitale	122,838.00	122,838.00	122,838.00	62,354.67	50.76%	50.76%
Mjetet e bartura	4	-	91,915.99	18,865.45	20.52%	20.52%
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet	-	7,000.00	7,000.00	4,166.50	59.52%	59.52%
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet	-	8,950.00	8,950.00	4,698.95	52.50%	52.50%
Investimet Kapitale	-	75,965.99	75,965.99	10,000.00	13.16%	13.16%
Grantet - Donacionet	5	-	2,469.85	-	0.00%	0.00%
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet	-	17.50	17.50	-	0.00%	0.00%
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Investimet Kapitale	-	2,452.35	2,452.35	-	0.00%	0.00%

Gjatë këtij nëntë mujori të vitit 2022 ka ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe aktual siç janë:

Transferi i donacioneve në shumë totale **2,469.85 €**, prej tyre **260.98 €** nga **UN-HABITAT** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale, **17.50 €** nga **KOSTT** në kategorinë Mallra dhe shërbime, **356.50€** nga **SAVE THE CHILDREN** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale, **1,834.87€** nga **DEMOS** dhe **SIDA** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale .

Kategoria e pagave është rritur në shumë prej **15,522.04€** për mbulimin e shtesave në paga për përfituesit nga Ligji për rimëkëmbje ekonomike për punëtorët shëndetësor në QKMF.


Transferi i të hyrave të pashpenzuara të vitit 2021 të bartura për shpenzim në vitin 2022 në shumë prej **91,915.99 €**, prej tyre: 7,000.00€ në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, 8,950.00€ në kategorinë e Subvencioneve dhe transfereve dhe 75,965.99€ në kategorinë e investimeve kapitale.

TË HYRAT BUXHETORE 2022

